

BIO E ANETAREVE TE KESHILLIT DREJTUES

BRUNILDA PAPA (JAKOVI)

Brunilda Papa (Jakovi), aktualisht Drejtore e Njesisë së Operacioneve të Bankës (COO), ka një eksperiencë të gjatë kryesisht në sektorin bankar.

Znj. Papa (Jakovi) filloi karrierën e saj në American Business Center Ltd Tiranë, si Përgjegjëse e Kontabilitetit dhe Koordinatore Projekti. Karrierën e saj ajo e zhvilloi në bankën NBG Albania ShA ku filloi në vitin 1996 si Specialiste e Lartë e Kontabilitetit, e më tej si Përgjegjëse e Kontabilitetit, Përgjegjëse e Njesisë së Financës dhe Kontabilitetit, Drejtore e Divizionit të Financës dhe Kontabilitetit, Drejtore e Financës dhe prej vitit 2015 Drejtore e Operacioneve dhe Financës (COO & CFO).

Eksperienca e saj e gjatë në sistemin bankar në Shqipëri është një avantazh i madh për Bankën. Znj. Papa (Jakovi) luajti një rol kyç në procesin e bashkimit të ish Bankës NBG Albania ShA me Bankën Amerikane të Investimeve ShA në vitin 2018.

Znj. Papa (Jakovi) është diplomuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, dega Financë. Në vitin 2008, ajo përfundoi MBA në Financë Banke, në Universitetin New York Tirana & IUKB Switzerland.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al